



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Sekretari i Përgjithshëm

6762/1
Nr. _____ Prot. _____

Tiranë, më 30 09 2015

LËNDA : Dërgohet Udhëzimi i Përbashkët nr.35, datë 14.9.2015

DREJTUAR : DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE _____

ZYRËS ARSIMORE _____

Bashkangjitur shkresës po ju dërgojmë për zbatim Udhëzimin e Përbashkët Nr.35, datë 14.9.2015 "Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Përbashkët nr.51, datë 20.9.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Financave "Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar".

Kërkojmë nga ana juaj zbatimin me korrektësi të të gjitha kriterëve për zbatimin e tij dhe respektimin e afateve kohore dhe formatin e raportimit të të dhënave në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PLARENT NDRECA

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 6762 Prot. Tiranë/14.09 2015

MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. 12934/3 Prot. Tiranë, 21.9.2015

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 35, datë 14 09 2015

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR.51 DATË 20.09.2013 TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE MINISTRIT TË FINANCAVE "PËR PROCEDURAT E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË BUXHETIT TE SHTETIT PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 47 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014 "Për buxhetin e vitit 2015", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollë, të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar, me Vendimin nr.707, datë 26.8.2015 të Këshillit të Ministrave 2010 "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollë, të sistemit arsimor parauniversitar", të Vendimit nr. 843, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM)", i ndryshuar si dhe të Vendimit nr. 9, datë 4.1.2013 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimit të teksteve shkollë për nxënësit e shkollave të arsimit profesional, nxënësit e pakicave kombëtare dhe nxënësit shqiptare që jetojnë e arsimohen në diasporë",

UDHËZOJMË:

Në Udhëzimin nr.51, datë 20.09.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Financave "Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar", bëhen ndryshimet dhe shtesat sa vijon:

si pikën "4. Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore", bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

I për nxënësit në arsimin parauniversitar që:

c) *vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara*, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Çaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP-së), sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar.

ç) *vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti.*

çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në formën "Transferimesh tek individët", në masën 100 për qind të tij.

si pikës 4.7 shtohen kategoritë përfituese të fëmijëve/ nxënësve me këtë përmbajtje:

- a) *Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, viktimat të trafikimit*, të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme.
- b) *Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, që gëzojnë statusin e viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit* në përputhje me Vendimin nr. 582, datë 27.07.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Procedurave Standarde të veprimit për Identifikimin dhe referimin e viktimave/ Viktimave të Mundshme të Trafikimit".
- c) *Për individët e moshës shkollore të arsimit bazë, të cilët janë në institucionet e paraburgimit/vuajtjes së dënimit.*
- d) *Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, të shtruar në Shërbimin Onkologjik në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".* Kërkesa dhe sasia për tekstet shkollore dërgohet nga ky shërbim në muajin gusht të çdo viti.
- e) *Për fëmijët e policëve të rënë në detyrë.*
- f) *Për çdo fëmijë që është i tretë e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje.*
- g) *Për tekstet shkollore të fëmijëve egjiptianë, nga klasa I deri IX*, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës egjiptianë, duhet të dorëzojnë në njësitë arsimore vendore Drejtoritë Arsimore Rajonale/ Zyrat Arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie.
- h) *Për tekstet shkollore të fëmijëve, nga klasa I deri IX, të cilët janë përfitues në institucionet e kujdesit social rezidencial publik, në Qendra Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore të Emergjencës*, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës, duhet të bashkërendojnë punën me drejtoritë e institucioneve të cituara më lart dhe dorëzojnë në Drejtoritë Arsimore Rajonale/ Zyrat Arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie.

çmimi i blerjes së teksteve shkollore të arsimit bazë mbulohet në masën 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

pikës 6, shtohen pika 7-të, me këtë përmbajtje:

7. Për kategoritë e nxënësve si më poshtë, porosia dhe blerja e teksteve realizohet nga institucioni arsimor/shkolla, në emër të nxënësve/prindërve. Likuidimi i faturës tatimore/pagesa ndaj subjekteve /shtëpive botuese realizohet drejtpërdrejt prej njësisve arsimore vendore (DAR/ZA-ve) me fondet e miratuara si "Transferte tek individët" në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në llogaritë bankare të shitësit/shtëpive botuese.

- a) për nxënësit në arsimin parauniversitar që gëzojnë statusin ligjor të jetimit;
- b) Për nxënësit/ fëmijët e policëve të rënë në detyrë.
- c) për nxënësve/fëmijëve romë, nga klasa I deri IX;
- d) për tekstet shkollore të fëmijëve egjiptianë, nga klasa I deri IX,
- e) për tekstet shkollore të nxënësve që gëzojnë statusin e të verbërve;
- f) për tekstet shkollore të nxënësve të pakicave kombëtare, nga klasa I deri IX;
- g) për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, të shtruar në Shërbimin Onkologjik në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
- h) për tekstet shkollore nxënësit / individët e moshës shkollore të arsimit bazë, të cilët janë në institucionet e paraburgimit/vuajtjes së dënimit.

Për kategoritë e përmendura në pikën 7-të, institucion arsimor/shkolla, harton proces-verbal të veçantë ku pasqyrohen kërkesa/porosia për tekste shkollore, lista e nxënësve sipas kategorive të përcaktuar më lart e detajuar të nxënësve për çdo klasë/institucion arsimor, *si dhe faturat tatimore për blerjen e teksteve në emër të nxënësve, së bashku me aktin e marrjes në dorëzim të teksteve nga furnitori/botuesi.* Kopje origjinale të këtij dokumentacioni së bashku me kërkesën për financim dërgohen zyrtarisht në Njësinë Arsimore Vendore.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Njësinë Arsimore Vendore (DAR/ZA-t).

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI I FINANCAVE

SHKËLQIM CANI



MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

LINDITA NIKOLLA

